



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:057809
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05632801
KPPP.nr.909/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit U.P.T. "Braca - Simic", me NRB:80554915, me seli në Kllkot, fshati Gërçare, kundër debitorit Komuna e Kllkotit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.165/15 të datës 30.04.2015, të Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Kllkotit, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.165/15 i datës 30.04.2015, i Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,559.00 € (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë nëntë euro) sipas Faturës Nr.7/13 të datës 07.03.2013, Faturës Nr.10/13 të datës 05.04.2013, Faturës Nr.9/13 të datës 09.04.2013, Faturës Nr.14/13 të datës 13.04.2013, Faturës Nr.17/13 të datës 16.05.2013, Faturës Nr.17/13 të datës 22.05.2013, Faturës Nr.25/13 të datës 09.09.2013, Faturës Nr.21/13 të datës 30.09.2013.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Kllkotit, dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 165/15 i datës 30.04.2015, i Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi, sa i përket shumës prej 487.00 € (katër qind e tetëdhjetë e shtatë euro) së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 3.5 %.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit U.P.T. "Braca - Simic", ndaj debitorit Komuna e Kllkotit, sipas urdhrit P.nr.165/15 të datës 30.04.2015, për shumën prej 2,559.00 € (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë nëntë euro), sipas Faturës Nr.7/13

të datës 07.03.2013, Faturës Nr.10/13 të datës 05.04.2013, Faturës Nr.9/13 të datës 09.04.2013, Faturës Nr.14/13 të datës 13.04.2013, Faturës Nr.17/13 të datës 16.305.2013, Faturës Nr.17/13 të datës 22.05.2013, Faturës Nr.25/13 të datës 09.09.2013, Faturës Nr.21/13 të datës 30.09.2013

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin përmbarimor P.nr.165/15 të datës 30.04.2015, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.7/13 të datës 07.03.2013; Faturës Nr.10/13 të datës 05.04.2013; Faturës Nr.9/13 të datës 09.04.2013; Faturës Nr.14/13 të datës 13.04.2013; Faturës Nr.17/13 të datës 16.05.2013; Faturës Nr.17/13 të datës 22.05.2013; Faturës Nr. 25/13 të datës 09.09.2013; Faturës Nr.21/13 të datës 30.09.2013; Faturës Nr. 31/13 të datës 26.10.2013 dhe Faturës Nr.35/13 të datës 01.12.2013, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit kryesor shumën prej 3,046.00 €, me kamatë prej 3.5 %, si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se ekziston dyshimi se faturat e lëshuara janë fiktive nga ana e kreditorit dhe ish kryetarit të komunës, pasi që të gjitha faturat nuk përmbajnë llogarinë fiskale. Tutje ka shtuar se për shkak të dyshimit rasti është paraqitur në prokurori me datë 09.12.2014, andaj i ka propozuar gjykatës që pritet raporti nga prokuroria pastaj te vendos lidhur me këtë çështje.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka deklaruar se pretendimet e debitorit se nuk ka borxh janë të paqëndrueshme pasi që për secilën ekzistojnë faturat e theksuara në propozim andaj ka propozuar që të vazhdohet me procedurën , të lejohet përmbarimi në shumën prej 3,046.00 €.

Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr.24/2015 të datës 13.07.2015, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.165/15 të datës 30.04.2015.

Debitori me datën 28.07.2015, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit të anulohet dhe të pezullohet procedura përmbartimore deri sa prokuroria të përfundoj hetimet.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.1330/22 të datës 04.04.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr.24/15 të datës 02.12.2020, të Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbartimor P.nr.165/15 i datës 30.04.2015, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr.7/13 të datës 07.03.2013, Faturës Nr.10/13 të datës 05.04.2013, Faturës Nr.9/13 të datës 09.04.2013, Faturës Nr.14/13 të datës 13.04.2013, Faturës Nr.17/13 të datës 16.305.2013, Faturës Nr.17/13 të datës 22.05.2013, Faturës Nr.25/13 të datës 09.09.2013, Faturës Nr.21/13 të datës 30.09.2013, për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata gjeti se Fatura Nr.7/13 e datës 07.03.2013, Fatura Nr.10/13 e datës 05.04.2013, Fatura Nr.9/13 e datës 09.04.2013, Fatura Nr. 14/13 e datës 13.04.2013, Fatura Nr.17/13 e datës 16.305.2013, Fatura Nr.17/13 e datës 22.05.2013, Fatura Nr.25/13 e datës 09.09.2013, Fatura Nr.21/13 e datës 30.09.2013, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që këto fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se të njëjtat janë

dorëzuar tek debitori, pasi që të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe as të vulosura nga ana e debitorit, dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.165/15 i datës 30.04.2015, për shumën në vlerë prej 487.00 € për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr.31/13 të datës 26.10.2013, Faturën Nr.35/13 të datës 01.12.2013, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën e pranimin të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbarruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 3.5%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet

se: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 487.00 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: “Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.909/23, datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.